



FIRMOSET MEMORANDUMI SHQIPËRI-ITALI

Drejtori i Aviacionit Civil shqiptar
Krislen Keri dhe Drejtori i Aviacionit
Civil italian Alessio Quaranta, kanë
firmosur në Tiranë...

faqe 2



FIRMOSET MEMORANDUMI SHQIPËRI- TURQI

Firmoset marrëveshja e
bashkëpunimit mes Autoritetit Civil
shqiptar dhe atij turk me qëllim
forcimin...

faqe 4

Maj 2018 - Botimi I

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



OPINION

BULETINI MUJOR,
DOMOSDOSHMËRI NË
SFIDAT E KOHËS

faqe 2

TË REJAT E FUNDIT

AAC MIRATON 13
DESTINACIONE TË REJA

TIRANË Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar ka miratuar lejet e fluturimit për 13 destinacione të reja, në pjesën më të madhe drejt kontinentit Europian, ndërkohë që për herë të parë do të ketë fluturime direkte dhe me Izraelin. Nga këto destinacione të reja, 11 janë destinacione sezonale...

STATISTIKA

568 MIJË PASAGJERË NË 3
MUJORIN E PARË TË 2018

TIRANË Numri i pasagjerëve në 3 muajt e parë të 2018 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka një tendencë në rritje. Shifra në total shkon në 568 mijë, destinacionet kryesore janë me Italinë...



RAPORTI I PERFORMANCËS

Cilat janë kompanitë që kanë patur më shumë vonesa dhe anulime të fluturimeve

TABELA Raporti i Performancës vlerëson korrektësinë e kompanive të ndryshme ajrore që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza". Raporti paraqet të gjitha kompanitë ajrore dhe performancën e tyre që lidhet me faktorë si nisja në orarin e përcaktuar ose jo, apo situata të tjera si anulim fluturimi. Më shumë lexoni në brendësi...

faqe 5



BULETINI MUJOR

Domosdoshmëri në sfidat e kohës

Krislen Keri
Drejtor Ekzekutiv i AAC

Në 6 muajt e parë të këtij mandati qeverisës, shumë ndryshime kanë ndodhur në Autoritetin e Aviacionit Civil shqiptar dhe publikimi, për herë të parë, i një buletini për punën e Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar vjen si një domosdoshmëri për ti dhënë një dimension perëndimor institucionit, por edhe për ti dhënë grupeve të interesit, informacion të detajuar për aktivitetet institucionit. Në nder të emrit të parë të institucionit në vitet 1930, kur është regjistruar edhe shoqëria e parë ajrore shqiptare, buletini me frekuencë mujore do të mbaj emrin "Posta Ajrore" dhe do të shërbejë edhe për të rritur transparencën e institucionit me publikun e gjerë, dhe me median kombëtare. Menjëherë pas marrjes së detyrës, filluam analizën e detajuar të çdo sektori, për të identifikuar dhe prioritarizuar masat e nevojshme për rimëkëmbjen e institucionit më të lartë në fushën e aviacionit civil, për të rikthyer funksionalitetin dhe vendosjen e ligjshmërisë në çdo proces të punës së AAC. Një muaj më vonë, qeveria rikompozoi përbërjen e Këshillit Drejtues të AAC, me ekspertë të fushës, dhe menjëherë në mbledhjen e parë të këtij këshilli, u miratua propozimi i DE për ristrukturimin e institucionit, sipas një propozimi të financuar nga Komisioni Evropian dhe Eurocontrol, i cili në thelbin e vet ka rritjen e efikasitetit të punës së institucionit ku numri i drejtorëve u reduktua nga 9 në 5 dhe numri i punonjësve nga 83 në 67 punonjës. Me këtë konfigurim të ri të institucionit, ndoqëm procedurën e konfirmimit dhe

vendosjes së ligjshmërisë së emërimeve me DAP, dhe jemi në proces të publikimit të vakancave për 18 pozicione të lira. Paralelisht është duke u finalizuar plani i detajuar i trajnimeve për çdo pozicion, i cili synon të përfshijë kërkesat e nevojshme për kompetencat e stafit të AAC në realizimin e funksioneve të tyre, detyrim ky i organizatave ndërkombëtare ku Shqipëria aderohet. Një proces tjetër tepër i rëndësishëm është hartimi i Sistemit të Manaxhimit të Cilësisë, ku një konsulent i specializuar do të na asistojë deri në Shtator, për të unifikuar në një dokument të vetëm të gjithë proceset e punës së AAC, në atë që do të jetë Manuali i Integruar i Manaxhimit të Cilësisë, mbi bazën e të cilit synojmë të certifikohemi ISO 9001 brenda fundit të vitit. AAC është e angazhuar në rritjen e aplikimit të efektshëm të standardeve dhe rekomandimeve të Organizatës ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe jemi duke punuar intensivisht për rritjen me mbi 70% të indikatorit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, gjithashtu brenda fundit të vitit. Në fund të kësaj hyrje të buletinit tonë të parë, përcjell entuziazmin dhe mirënjohjen e thellë të ekspertëve të aviacionit civil për mbështetjen e qeverisë për fushën, në drejtim të promovimit të fillimit të zhvillimit të një aeroporti të ri ndërkombëtar në Vlorë dhe aktivizimin e prapambetur të Aeroportit të Kukësit. Gjithashtu, mbështetja për hapjen e kompanisë kombëtare Air Albania, është një lajm shumë i mirë për industrinë tonë, pasi këto zhvillime bashkë, do të përkthehen në dyfishim dhe trefishim të aktivitetit aeronautik në vend deri në vitin 2025 dhe kjo përveç se na ngarkon me përgjegjësi, na jep edhe

disa objektiva ku gjithësecili prej nesh është krenar i të qenurit pjesë. Në faqet e para do të pasqyrohen aktivitetet të ndryshme të autoritetit, që kanë edhe ndikim të konsiderueshëm në opinion. Më tej stafi i Komunikimit dhe Medias, ka parashikuar publikimin e raportit të performancës. Ky raport do të japë një përmbledhje mujore të gjithë atyre kompanive që kanë regjistruar më shumë vonesa ose anulime fluturimesh, dhe do të shoqërohet me një tabelë ku do të jepen këto të dhëna të detajuara. Gjithashtu do të jetë një pasqyrë reale në ndihmë të pasagjerëve shqiptar, për të udhëtuar të sigurt dhe të qetë drejt destinacioneve përkatëse. Vëmendje do të kushtojmë fluksit të pasagjerëve dhe kompanive që kryejnë më shumë fluturime nga, dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza. Rubrikat që besojmë do të priten me kuriozitet në opinion dhe nga ekspertë të fushës, lidhet me aspekte të ndryshme në aviacion, si e drejta e pasagjerëve, siguria në aviacion, e ardhmja, aeroportet etj. Si element të fundit, grupi hartues i materialeve dhe i këtij buletini ka menduar t'ju ofrojë disa kuriozitete që lidhen me aplikimin e teknologjive apo elementeve të ndryshme në aviacionin botëror. Ne ju ftojmë ta lexoni këtë buletin, pasi jemi të sigurt se do të gjeni materiale të mirë punuara dhe profesionale, por gjithashtu do të merrni përgjigje për shumë pyetje, që mund të kenë në lidhje me aviacionin civil shqiptar dhe atë botëror. Për çdo kërkesë na kontaktoni në adresën tonë zyrtare, www.aaa.gov.al

Lexim të këndshëm!

FIRMOSET MEMORANDUMI SHQIPËRI-ITALI



Foto nga ceremonia e firmosjes

Drejtori i Aviacionit Civil shqiptar Krislen Keri dhe Drejtori i Aviacionit Civil italian Alessio Quaranta, kanë firmosur në Tiranë, Memorandumin e Mirëkuptimit, me synim forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve. Gjatë takimit Drejtori i "AAC" Keri, e njohu homologun italian me zhvillimet në aviacionin shqiptar, sfidat dhe objektivat e të ardhmes, siç janë hapja e 2 aeroporteve, një në Vlorë dhe në Kukës. Keri u ndal edhe te nismat e ndërmarra së fundmi, për të mbrojtur të drejtat e pasagjerëve dhe rritjen e sigurisë në aviacion, për të mos toleruar asnjë vonesë të paarsyeshme dhe mos informim të pasagjerëve. Nga ana e tij

Drejtori i Aviacionit Civil italian Alessio Quaranta, vlerësoi zhvillimet e fundit në aviacionin shqiptar dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar ngushtësisht me palën shqiptare për të përballuar disa nga sfidat që lidhen me rritjen e kapaciteteve, duke ofruar dhe asistencën e "AACI", për trajnime të stafit si teknikisht dhe me ekspertizë. Në memorandum palët bien dakord që të bashkëpunojnë në nivele të larta, për të standartizuar dhe harmonizuar praktikrat dhe procedurat në fushën e parrezikshmërisë në aviacion. Disa nga pikat kryesore të Memorandumit të Mirëkuptimit: 1. Parrezikshmëria në Aviacion, palët bien dakord për shkëmbyer informacion. Pala italiane ofron ekspertizën e saj përfshirë dhe

trajnime për operacione të ndryshme për inspektorët. 2. Palët do të vazhdojnë të ruajnë kontakte intensive për të respektuar të drejtat e pasagjerëve në aeroportet respektive, dhe angazhohen të marrin masat e nevojshme për të mos lejuar shkelje. 3. Autoriteti i Aviacionit Civil italian, angazhohet për të dhënë asistentë dhe ekspertizë në hartimin e dokumentacioneve për certifikimin, për programet shtetërore të sigurisë, për operimet e droneve etj. Në përfundim të takimit, u ra dakord që palët të zhvillojnë disa takime të tjera, në nivel teknik, për të ruajtur nivelin e lartë të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit.

AAC MERR PJESE NË PANAIRIN E PUNËS PËR 2018



Autoriteti i Aviacionit Civil, ka marrë pjesë në Panairin e "Punës dhe Studimit", që u mbajt në Tiranë, duke ofruar informacion të detajuar për të gjithë të interesuarit që kërkojnë të bëhen pjesë e jona dhe jo vetëm. Stendën e Aviacionit, e kanë vizituar në ditën e hapjes Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erjon Veliaj dhe kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Nikolin Jaka, të

cilët Drejtori i Aviacionit Civil Krislen Keri, i njohu me projektet në aviacion dhe domosdoshmërinë në rritje për staf të kualifikuar të fushës. Në këtë panair "AAC", prezantoi disa mundësi punësimi në aviacion, për profesionistë të fushës në ekspertizat e mëposhtme:

- 1-Inxhinieri Elektronike
- 2-Inxhinieri Mekanike dhe sistemesh
- 3-Shkenca Ekonomike
- 4-Shkenca Kompjuterike

FIRMOSET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MES AUTORITETIT CIVIL SHQIPTAR DHE ATIJ TURK

Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar dhe ai turk kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me qëllim forcimin dhe shkëmbimin e ekspertizës në këtë fushë. Gjatë takimit me zv. Drejtorin e Përgjithshëm turk Haydar Balçin, Keri e falenderoi për gatishmërinë në forcimin dhe rritjen e bashkëpunimit në aviacionin civil, në veçanti për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës dhe mundësinë e krijimit të kompanisë së përbashkët ajrore "Air Albania". Z. Keri theksoi se falë mbështetjes dhe vëmendjes së madhe që Qeveria Shqiptare dhe Kryeministri Rama po japin ndaj aviacionit, do të ketë zhvillime pozitive në këtë industri me impakt të lartë në turizëm dhe ekonominë e vendit.



Në Foto:
Drejtori i AAC z. Krislen Keri dhe z. Haydar Balçin

Hap shumë i rëndësishëm për Aviacionin Civil shqiptar

Nga ana e tij z. Balçin i shprehu vlerësimet z. Keri duke theksuar se Aviacionit Civil turk është i gatshëm të asistoj me eksperiencën e gjatë autoritetin shqiptar për plotësimin e nevojave teknike. Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar, synon që nëpërmjet kësaj marrëveshje të rris kapacitetin teknik institucional, me qëllim përballimin me sukses së aktivitetit të shtuar aeronautik, veçanërisht në drejtim të mbikëqyrjes së operatoreve ajror, mbikëqyrjes Aeroportuale dhe mbikëqyrjes së sigurisë në aviacion. Një tjetër fushë bashkëpunimi do të jetë pjesa e trajnimeve dhe edukimit

në aviacionin civil, ku Turqia e ofron këtë shërbim në rreth 50 institucione të specializuara. Zv. Drejtori përgjegjës për aeroportet në Turqi, z. Erel shprehu gatishmërinë për të koordinuar përpjekjet e autoriteteve shqiptare për rilindjen e edukimit për të rinjtë shqiptarë në fushën e aviacionit civil, edukim ky që nuk ofrohet më në vendin tonë që prej mbylljes së Shkollës së Aviacionit në Vlorë. Autoriteti i Aviacionit turk ka nën mbikëqyrje 57 aeroporte, 33 nga të cilët aeroporte ndërkombëtarë, 13 kompani ajrore dhe shumë operatorë të tjerë të aviacionit të përgjithshëm. Aktiviteti aeronautik në vend

mbikëqyret nga një staf i kualifikuar rregullator prej 270 personash. Edukimi për të rinjtë shqiptarë në fushën e aviacionit civil, edukim ky që nuk ofrohet më në vendin tonë që prej mbylljes së Shkollës së Aviacionit në Vlorë. Autoriteti i Aviacionit turk ka nën mbikëqyrje 57 aeroporte, 33 nga të cilët aeroporte ndërkombëtarë, 13 kompani ajrore dhe shumë operatorë të tjerë të aviacionit të përgjithshëm. Aktiviteti aeronautik në vend mbikëqyret nga një staf i kualifikuar rregullator prej 270 personash.



TAKIMI DREJTORËVE RAJONALË TË AAC NË TIRANË

U zhvillua në Tiranë takimi i Drejtorëve Ekzekutiv të Aviacionit Civil të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Shqipërisë. Në përfundim të takimit 2-ditor të organizuar nga Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar Krislen Keri, 4 Drejtorët Ekzekutiv dakordësuan deklaratën e përbashkët ku u zotuan për të vijuar bashkëpunimin në aspektet e sigurisë në aviacion, për të patur shkëmbime eksperiencash dhe trajnime në shërbim të zbatimit nga kompanitë e të drejtave të pasagjerit, të përmirësimit të inspektimeve të sigurisë në ajër, në forcimin e sigurisë kibernetike apo edhe adresimin e rregulloreve për pajisjet fluturuese të llojit dron. Krislen Keri, Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit Civil shqiptar, informoi homologët

e tij për objektivat e "AAC", si dhe theksoi se është e domosdoshme që 4 drejtoritë të kooperojnë më shpesh, për të adresuar sfida të njëjta të aviacionit në secilin shtet por edhe përmirësuar akoma më shumë shërbimet. Me Drejtorin Ekzekutiv të Kosovës, z. Dritan Gjonbalaj, u ra dakord se dy vendet duhet të punojnë ngushtësisht në fushën e sigurisë së ajrit, ku z. Keri kërkoi bashkëpunim të ngushtë për hartimin e planit kombëtar të sigurisë së ajrit (SSP). Në bisedën me homologun e Malit të Zi Dragan Djuroviç, z. Keri kërkoi bashkëpunim për të qenë pjesë e nismës "Një ndalesë Një kontroll" (one stop security), të cilën Mali i Zi e zbaton suksesshëm. Kalimi më sukses i një sfide të tillë do eliminonte dy kontrolle,

për pasagjerët që fluturojnë nga aeroporti Ndërkombëtar Nënë Tereza. Me drejtorin e Autoritetit Civil të Maqedonisë z. Goran Jandreovski, u ra dakord për të shkëmbyer eksperiencat dhe praktikatat më të mira, në rritjen e cilësisë së inspektimeve apo përgatitjen e burimeve njerëzore për standardet e kërkuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), nga e cila Autoriteti Maqedonas mori certifikatën e ekselencës në Shtator 2017. Palët ranë dakord për zhvillimin e takimeve më të shpeshta midis tyre dhe aplikimin për projekte të përbashkëta në fushën e aviacionit civil, në instrumentet e financimit të BE.



Në foto:
Drejtorët e AAC-ve të Rajonit

**4 DREJTORËT
EKZEKUTIV
TË RAJONIT
DAKORDËSUAN
DEKLARATËN E
PËRBASHKËT
KU U ZOTUAN
PËR TË VIJUAR
BASHKËPUNIMIN
NË ASPEKTET
E SIGURISË NË
AVIACION**

SHTOHEN 13 DESTINACIONE TË REJA NË PRAG TË SEZONIT TURISTIK

Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar ka miratuar lejet e fluturimit për 13 destinacione të reja, në pjesën më të madhe drejt kontinentit European, ndërkohë që për herë të parë do të ketë fluturime direkte dhe me Izraelin. Nga këto destinacione të reja, 11 janë destinacione sezonale, deri në fund të sezonit veror, ndërsa pjesa tjetër janë fluturime të rregullta. Trendi i këtij viti mund të quhet shumë pozitiv, pasi krahasuar me 2 vitet e kaluara ku ishin vetëm 9 destinacione, këtë vit në vetëm pak muaj shifra shkon në 13. Shtimi i linjave të reja, e hap edhe më shumë vendin dhe rrit kërkesat nga operatorët turistikë për të sjellë turistë në Shqipëri, që jemi të sigurt këtë vit do të jenë më të shumtë.

DESTINACIONET E REJA CHARTER

Kompania	Linja	Datat e Operimit	Statusi
Jet Time	Helsinki-Tiranë	11/5 - 28/9 2018	Kompani e re
Braathers Regional Aviation	Kopenhagën-Tiranë	2/6 - 18/8 2018	Kompani e re
Travel Service	Budapest-Tiranë		Kompani e vjetër.
			Destinacioni Budapest është risi.
Ural Airlines	Moskë-Tiranë	19/06 - 11/09 2018	
Enter Air	Gdansk/Poznan/Warsaw/Prague/Katowice/London	25/05-28/09 2018	Destinacione të reja (Gdansk/London Gatwick/Katowice/Prague)
	Gatwick-Tiranë		
Scandianvian Airlines	Göteborg-Tiranë	6/6 - 3/10 2018	Kompani e re

DESTINACIONE TE REJA SKEDULE

Israil	Tel Aviv- Tiranë	Fund Qershori – 26.10.18	Kompani e re
Wizz Air	Luton –Tiranë	19/04 – 27/10/18	Destinacion i ri



RAPORTI I PERFORMANCËS

Raporti i Performancës vlerëson korrektësinë e kompanive të ndryshme ajrore që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza. Raporti paraqet të gjitha kompanitë ajrore dhe performancën e tyre që lidhen me faktorë si nisja në orarin e përcaktuar ose jo, apo situata të tjera si anulim fluturimi. Duke u bazuar në indikatorët e mësipërm, gjeni të renditur tabelën përkatëse me ato kompani që kanë patur më shumë vonesa mbi 2 apo 3 orë, si dhe fluturimet e anuluar brenda ditës me nisje nga Aeroporti i Tiranës.

JA KOMPANITË QË KANË NUMRIN MË TË LARTË TË VONESAVE DHE ANULLIMEVE PËR 4-MUJORIN E PARË TË 2018

KOMPANIA	ANULLIME	VONESA MBI 2 ORË
ERNEST S.P.A.	2	9
ADRIA AIRWAYS	5	5
BLUE PANORAMA	0	6
TURKISH AIRLINES	0	4
BRITISH AIRWAYS	0	3
WIZZ AIR	0	1
LUFTHANSA	1	1
MISTRAL	0	1
VOLOTEA	0	1
AEGEAN AIRLINES	0	0
AIR SERBIA	0	0
AUSTRIAN AIRLINES	1	0
ALITALIA	1	0
ALBAWINGS	0	0
PEGASUS	0	0
JET AIRFLY	0	0
TRANSAVIA	0	0

TË DREJTAT E PASAGJERIT



Një nga prioritetet e Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar, është respektimi i të drejtave të pasagjerit ndaj çdo lloj shkelje që mund t'ju bëhet nga kompanitë ajrore. Duke parë vonesat e shpeshta të disa operatorëve në fundin e vitit 2017, dhe në fillim të 2018, stafi i "AAC" ka ndihmuar qindra pasagjerë, fluturimi i të cilëve ishte anuluar ose vonuar pa arsye. Pas këtij insistimi, për herë të parë në 25 vite, dhjetëra pasagjerë shqiptar kanë përfituar kompensim financiar mbi 200 euro nga kompanitë përkatëse. Më poshtë keni edhe një tabelë me ankesat e plotësuara dhe ato që janë pranuar.

Bazuar në të dhënat zyrtare janë gjithsej 67 pasagjerë që janë kompensuar nga kompania që ka vonuar ose anuluar fluturimin.


Data	Destinacioni	Statusi	Formular/ pasagjerë
09.01.2018	TIA-PSA	VONESE	85 FORMULARE/ 85 PASAGJERE
	TIA-CUF	ANULLUAR	12 FORMULARE/13 PASAGJERE
14.04.2018	TIA-VRN	ANULLUAR	14 FORMULARE/52 PASAGJERE
	TIA-MXP	ANULLUAR	27 FORMULARE/ 44 PASAGJERE
	PSA-TIA	VONESE	1 FORMULARE/3 PASAGJERE

Ndërkohë në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza, janë vendosur edhe tabelat përkatëse që orientojnë qytetarët si të zgjidhin çdo problematikë që kanë me kompanitë ajrore, si për vonesat e fluturimeve, anulimeve, humbje ose dëmtim të bagazhit apo lëvizja e personave me aftësi të kufizuar.

KOMPANITË ME NUMRIN MË TË MADH TË FLUTURIMEVE NË 3 MUJORIN E PARË 2018

Referuar tabelës rezultojn se përqindjen më të lartë të fluturimeve e ka kompania “Blue Panorama”, me destinacion drejt disa qyteteve italiane, me 22% të totalit (1200 fluturime), duke u ndjekur nga kompania Ernest “S.p.a” me 13% ndaj totalit (692 fluturime). Kompania me më pak fluturime është “Volotea” e cila brenda tre muajve ka kryer vetëm 6 fluturime dhe zotëron 0% të fluturimeve ndaj totalit.

Fluturime për linjat e rregullta në tre mujorin e parë 2018




Grafiku 1:
Grafiku i mësipërm tregon në përqindje totalin e fluturimeve

PASAGJERË JAN-MAR 2018					
	Shoqëritë ajrore	Janar 2018	Shkurt 2018	Mars 2018	Totali i pax për çdo kompani
1	Swift Air		-		-
2	Adria Airways	6,825	5,597	8,123	20,545
3	Alitalia	17,235	15,231	18,396	50,862
4	Austrian Airlines	9,212	8,044	10,517	27,773
5	British Airways	9,045	8,336	8,410	25,791
6	Jetairfly	3,640	3,961	4,273	11,874
7	Lufthansa	4,443	4,182	4,837	13,462
8	Aegean Airlines	7,617	6,302	7,657	21,576
9	Turkish Airlines	13,756	11,672	14,754	40,182
10	Pegasus Airlines	6,685	5,458	6,227	18,370
11	Blue Panorama	67,004	42,253	52,249	161,506
12	Air Serbia	2,538	1,922	3,055	7,515
13	Volotea			608	608
14	Mistral Air	5,818	4,307	1,553	11,678
15	Albawings	17,394	12,457	18,152	48,003
16	Wizz Air	4,747	3,938	4,996	13,681
17	Ernest Airlines	36,770	20,531	24,300	81,601
18	Transavia			3,334	3,334
19	SHUMA	212,729	154,191	191,441	558,361
19	Charter	1,462	324	721	2,507
	TOTAL	214,191	154,515	192,162	568,868



PASAGJERË JANAR-MARS 2018

Numri i pasagjerëve në 3 muajt e parë të 2018 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka një tendencë në rritje prej 11.8 % nga viti në vit. Shifra në total shkon në 568 mijë, destinacionet kryesore janë me Italinë. Tabela në të majtë.



PASAGJERË JANAR-MARS NË 5 VITET E FUNDIT

INSPEKTIVE TRAJNIME LICENSIME

1. Bashkëpunimi me Eurocontrol

Në prill të 2018, "AAC" dhe "EUROCONTROL" detajuan planin e punës për vitin 2018, në lidhje me mbështetjen që Eurocontrol do të japë "AAC"-së, në kuadrin e bashkëpunimit të ndërsjellë midis dy organizatave. Ky bashkëpunim për vitin 2018, do të fokusohet në zhvillimin e procedurave lokale të NSA, në përputhje me objektivat e legjislacionit të BE-së, për "Një Qiell të Vetëm European", si dhe përmirësimin e burimeve dhe proceseve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë.

2. Përgatitja e Planit Kombëtar për Implementimin e Objektiveve për "Një Qiell të Vetëm European"

Në bashkëpunim me Forcat Ajrore, Albcontrol dhe administratën e Aeroportit "Nënë Tereza", AAC përfundoi përgatitjen e planit kombëtar të LSSIP 2017. LSSIP, përbën një plan implementimi afatshkurtër/afatmesëm që përmban veprimet e shteteve të "Eurocontrol", për të arritur "Objektivat e Zbatimit", të përcaktuara nga Master Plani European për ATM, si dhe për të përmirësuar performancën e Sistemit Kombëtar të ATM-ve.

3. Në fushën e ATM, AAC ka validuar rreth 62 licensa të ATCO për kategori të ndryshme.

4. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrorë dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, gjatë periudhës Janar-Mars 2018, ka kryer gjithsej 21 inspektime dhe auditime ndaj kompanive të ndryshme ajrore që operojnë në aeroportin e Rinasit.

5. Në zbatim të planit të punës, në datë 26 Prill është kryer një inspektim i pa njoftuar në Agjentin e Rregullt për Kargon dhe Postën, në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".

Inspektimi konsistoi në pikat e mëposhtme:

a) Struktura e Agjentit të Rregullt



b) Procedura e Raportimit në rast incidenti.

c) Zëvendësimi i personit përgjegjës në rast mungesë.

d) Trajnimi i stafit që përpunon kargo dhe i personit përgjegjës për sigurinë.

e) Funkcionaliteti i pajisjeve të sigurisë dhe kontrollet alternative në rast defekti, etj.

6. Ka përfunduar procesi i Certifikimit të Agjentëve të rinj të patrullimit të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", pas mbikëqyrjes së trajnimit OJT-ve. Kjo erdhi pas verifikimit të përputhshmërisë së dokumentacionit të dërguar nga subjekti kontraktues (ICTS Albania).

7. Aktivitetet që ka marrë pjesë Stafi i AAC-së: Drejtori i Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Org. të Mirëmbajtjes, mori pjesë në Samitin e Aviacionit, organizuar në Berlin, Gjermani. Ky organizim shërbeu si një platformë për profesionistët në industrinë e aviacionit. Gjatë këtyre ditëve u organizuan konferenca dhe forume për të bashkuar personazhe të rëndësishëm në aviacion, si dhe u diskutua për sfidat që ka industria.

8. Inspektori për Aerodromet dhe Këshilltari i Drejtorit Ekzekutiv, morën pjesë në workshopin "Communication in Aviation Crisis". Mbledhja u organizua në Podgoricë, në Malin e Zi, ishte një aktivitet mjaft i rëndësishëm ku u diskutua për mënyrat më efikase të komunikimit, në situata krizash kombëtare dhe ndërkombëtare në aviacion.





KURIOZITETE TEKNOLOGJI

* Vinci Group blen 12 aeroporte të reja

Grupi Vinci Airports, ka arritur marrëveshjet për të blerë një portofol të gjerë aeroportesh në Botë, duke filluar në SHBA, Europë dhe Amerikën Jugore. Grupi me qendër në Francë, nuk ka bërë publike detajet e marrëveshjeve, por ka arritur që të blejë 12 aeroporte në Botë, që ndodhen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kosta Rika, Irlandën e Veriut dhe Suedi. Kjo blerje e madhe i jep grupit me qendër në Francë, një dritare në tregun më të madh në botë në aviacion që është ai i SHBA-ve. Kjo blerje e çon rrjetin global Vinci, në 45 aeroporte total në gjithë Botën, me një fluks pasagjerësh që shkon në 182 milion në vit.



* Orlando gati pajisja që zhduk kontrollin dhe radhët e gjata

Aeroporti Ndërkombëtar i Orlandos në SHBA, ka filluar vendosjen e teknologjisë Biometrike për pasagjerët ndërkombëtar që do të hyjnë dhe dalin. Fondi prej 4 milion dollarësh, është miratuar nga Bordi i Autoritetit të Aviacionit Civil të Orlandos, dhe parashikon vendosjen e teknologjisë që njihet si "fytirë njohësja" ose skaner i fytyrës, duke ë bërë më të lehtë kalimin në pikat e kontrollit të 6 milion pasagjerëve të huaj, që udhëtojnë në këtë aeroport çdo vit. Drejtori i AAC-së Orlandos Frank Kruppenbacher, tha se qëllimi i kësaj mase është rritja e shërbimit cilësor ndaj pasagjerëve. Me aplikimin e kësaj teknologjie, evitohet përdorimi i pasaportës dhe krijimi i radhëve të gjata. Fillimisht kjo do të zbatohet me pasagjerët që vijnë nga Britania e Madhe, për ta zgjeruar më tej me shtete të tjera. Edhe Aeroporti Ndërkombëtar i Moskës "Domodedovo", po zbaton një projekt të tillë pilot, për Botërorin e futbollit që do të mbahet gjatë këtij viti.

* Raporti, 70 % e problemeve në bord nga përdoruesit e alkoolit

Një raport i Autoritetit të Aviacionit Civil të Britanisë së Madhe, ka arritur në përfundimin se rreth 70 % e problemeve që hasen gjatë një fluturimi në bord, lidhet me përdorimin e tepërt të alkoolit. Sipas raportit pasagjerët që tejkalojnë normën e alkoolit shkaktojnë edhe probleme të shumta në bord. Autoriteti i "AAC-së" në Britani, është duke diskutuar edhe nismën për të hequr nga dyqanet (duty free shops) shitjen e pijeve alkoolike.



* Kinë skaner trupor që zbulon 89 elemente të palejuaja në 0.7 sek

Autoritetet kineze kanë deklaruar se kanë gati pajisjen e re inteligjente të sigurisë, që mund të zbulojë në vetëm 0.7 sek, 89 elemente të palejuar. Pajisja është krijuar nga Koorporata Kineze e Shkencës dhe Hapësirës, dhe ka një saktësi deri në 95%. Ajo ka filluar të përdoret në Aeroportin Ndërkombëtar të Pekinit. Ky skaner i gjeneratës së fundit, mund të evidentojë sende me përbërje metali dhe jo vetëm që mund të fshehin udhëtarë të ndryshëm, që mund ti përdorin edhe për kontrabandë. Në Kinë skanimi në pjesën më të madhe të aeroporteve, bëhet me skanera të lëvizshëm me rreze X, duke ngritur herë pas here shqetësimin e rrezatimit të pasagjerët.

